

VENDIM
Nr. 177, datë 6.3.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 48, DATË 23.1.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR KRIJIMIN E UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË (UMT)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14, 16 e 23 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 5 e kreut IV të vendimit nr. 48, datë 23.1.2013 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Autoritetet dhe organet e tjera drejtuese emërohen dhe funksionojnë në përputhje me nenin 23 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Përbërja e organeve kolegjiale drejtuese, si: Senati Akademik dhe Këshilli i Administrimit (KADM) të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, deri në shpalljen e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet kolegjiale drejtuese të këtij universiteti do të jetë si më poshtë vijon:

a) Senati Akademik i UMT-së përbëhet nga: anëtarët e zgjedhur të personelit akademik të njësive kryesore ekzistuese, të ish-Fakultetit të Mjekësisë dhe të ish-Fakultetit të Infermierisë në UT; 1 (një) përfaqësues i stafit joakademik të universitetit të caktuar nga rektori; 2 (dy) përfaqësues të studentëve, që janë kryetarët e qeverisë studentore të fakulteteve; autoritetet drejtuese të të tria njësive të reja kryesore dhe nga 2 (dy) përfaqësues të personelit akademik për secilën njësi kryesore të re. Përfaqësuesit e personelit akademik të njësive të reja kryesore caktohen nga këshilli i fakultetit.

b) KADM-ja i UMT-së përbëhet nga: anëtarët e zgjedhur të personelit akademik të njësive kryesore ekzistuese, Fakultetit të Mjekësisë dhe të Fakultetit të Infermierisë; 1 (një) përfaqësues nga personeli akademik, i zgjedhur nga këshilli i fakultetit, për secilën prej tri njësive të reja kryesore; 1 (një) përfaqësues të studentëve të zgjedhur nga fakulteti me numrin më të madh të studentëve. Numri i anëtarëve të caktuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës është një më pak se gjysma e numrit të anëtarëve të KADM-së.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha